



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1482 Prot.

Lezhë, më 04 . 02 . 2022

VENDIM

Nr. 8 Datë 01 . 02 . 2022

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Lezhë së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për dëmin e shkaktuar nga djegia e banesës të shtetases M. D., banore në lagjen "Varosh", Bashkia Lezhë.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, mbi dëmin e shkaktuar në banesën e Znj. M. D., banore në lagjen "Varosh", Bashkia Lezhë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë

Vendosi:

I.Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lezhë për mbështetje financiare të shtetases Znj.M. D. për dëmtimin e banesës së saj nga zjarri.

A.Të miratojë dëmin e shkaktuar nga zjarri në vlerën	88431 lekë.
a)Demi i shkaktuar në ndertese	7431 lekë.
b)Demi i shkaktuar në orendi,mobilje e pajisje	81000 lekë.

B.Mbështetur ne VKM. Nr 329 dt.16.05.2012, kap3, pika 3, gërmat b dhe ç, kompensimi për dëmin e shkaktuar në anën ndërtimore të jetë në masën 50%, ndërsa kompensimi për dëmin e shkaktuar në orendi, mobilje e pajisje, mbështetur në kap 3, pika 3, gërma d, të VKM-së së mësipërme të jetë sa masa e dëmit të shkaktuar dhe konkretisht :

a)Vlera e kompensimit të dëmit në anën ndërtimore të jetë	3715 lekë.
b)Vlera e kompensimit të dëmit në orendi, mobilje e pajisje	81000 lekë.
Vlera totale	84715 lekë.

2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Lezhë.

3. Bashkia Lezhe t'i akordojë familjes së shtetases Znj.M.D. me Nr.ID. H.....C ndihmën emergjente në vlerën prej 84715 (tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë) lekë nga buxheti i Bashkisë Lezhë, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2022, bazuar në VKM nr.329 dt.16.05.2012.

4. Ndihma financiare që do t'i akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetases Znj.M. D., banesa e të cilës është dëmtuar nga zjarri.

5.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**

**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

